



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 102, datë 26.02.2020

PËR
MIRATIMIN E VLERËSIMIT DHE PIKËZIMIT PARAPRAK TË KANDIDATËVE, SI
DHE TË LISTËS SË KANDIDATËVE MË TË MIRË QË KONKURROJNË PËR NË
GJYKATËN E LARTË, NGA RADHËT E JURISTËVE TË SPIKATUR, NË
POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME
VENDIMIN NR. 109, DATË 09.07.2019, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikat 6, 7 dhe 8, të nenit 49, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në pikën 5, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”, si dhe në Vendimin e tij nr. 209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”, mbi propozimin e relatores së çështjes,

VENDOSI:

1. Miratimin e Vlerësimit dhe Pikëzimit Paraparak të kandidatit z. {...}, sipas Aktit të Vlerësimit dhe Pikëzimit Paraparak bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Miratimin e listës me kandidatët më të mirë, si më poshtë:
 1. Z. {...}
3. Zhvillimin e intervistës me kandidatin z. {...} më datë 27.02.2020, ora 10:30.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR